



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

CN.nr.127/2024

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Zenel Leku, kryetar, Muhamet Rexha dhe Nenad Lazic, anëtarë, në çështjen juridike përmbartimore të kreditorit Inspektorati Shëndetësorë, me adresë Instituti B, kati përdhese, rrethi i QKUK-së, në P., kundër debitorit Dr. M.K, Specialist i Përgjithshëm në SPSH N. O., "...", nr. ..., në P., të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Berhil Sasivari, avokat nga Prizreni, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit, të paraqitur kundër urdhrin përmbartimor P.nr.1453/2022 të datës 16.11.2022, të përmbartuesit Privat M.R., me seli në P., përkitazi me konfliktin e kompetencës, në seancën e kolegjit të mbajtur më 19.03.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

Për të vendosur në këtë çështje juridike, kompetente në pikëpamje lëndore është Gjykata Themelore në Prizren - Departamenti i Përgjithshëm, të cilës shkresat e lëndës i dërgohen në kompetencë të mëtejme.

A r s y e t i m i

Përmbartuesi Privat M.R., duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Inspektorati Shëndetësorë ka lejuar urdhrin përmbartimorë P.nr.1453/2022 të datës 16.11.2022, me të cilin ka urdhëruar debitorin Dr. M.K.,sipas dokumentit përmbartimor aktvendimit të Inspektoratit Shëndetësor Nr.10/L-070-21 të datës 07.09.2021, që t'ia paguajë shumën prej 1.000.00 € (njëmijë euro), si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore, nën kërcënim të përmbartimit të dhunshëm.

Debitori brenda afatit ligjor ka paraqitë prapësim duke e kundërshtuar në tërësi urdhrin përbarimor, me arsyetim se propozimi për përbarim është i parakohshëm, sepse data e plotfuqishmërisë dhe ekzekutueshmërisë së aktvendimit është 16.09.2022, ku kreditori si organ administrativ nuk ka dhënë afatin partitiv prej 15 ditë për plotësim vullnetar të detyrimeve dhe kjo paraqet shkelje të rëndë të dispozitave ligjore, pra nuk është i përshtatshëm për përbarim. I ka propozuar gjykatës që të aprovoj prapësimin e debitorit dhe të shfuqizojë në tërësi urdhrin për përbarim të Përbaruesit Privat.

Kreditore nuk ka paraqitë përgjigje në prapësim.

Gjykata Themelore në Prizren - Departamenti i Përgjithshëm, me aktvendimin PPP.nr.05/2023 të datës 09.03.2023, në pikën I të dispozitivit është shpallur jo kompetente në pikëpamje lëndore për të vendosur lidhur me prapësimin e debitorit Dr. M.K., Specialist i Përgjithshëm në SPSH N. O., me seli në P., i ushtruar kundër urdhrin përbarimorë P.nr.1453/2022 të datës 16.11.2022, të Përbaruesit Privat M.R., në P., ndërsa në pikën II të dispozitivit është vendosur që pas plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi, shkresat e lëndës PPP.nr.05/2023, do ti dërgohen në kompetencë Gjykatës Komerciale në Prishtinë.

Gjykata Komerciale e Kosovës - Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike me aktvendimin KPPP.nr.802/23 të datës 28.12.2023, në pikën I të dispozitivit ka vendosur që të hapë konflikt kompetence në mes të Gjykatës Komerciale të Kosovës - Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike dhe Gjykatës Themelore në Prizren - Departamenti i Përgjithshëm, për të vendosur në këtë çështje përbarimore. Në pikën II të dispozitivit është vendosur që lënda me komplet shkresat i dërgohet Gjykatës Supreme të Kosovës për të zgjidhur konfliktin e kompetencës lëndore.

Gjykata Supreme e Kosovës, ka vlerësuar se në këtë rast kemi të bëjmë me konfliktin e kompetencës midis gjykatave të ndryshme të cilin e zgjidh Gjykata Supreme e Kosovës, bazuar në nenin 25.2 të LPK-së dhe nenin 13 pika 7 të Ligjit Nr.08/L-015 Për Gjykatën Komerciale.

Nga shkresat e lëndës rezulton se kreditore, Inspektorati Shëndetësorë me seli në Prishtinë, më datë 16.11.2022 ka parashtruar propozim për përbarim te Përbaruesi Privat M.R., me të cilin ka kërkuar që të detyrohet debitori Dr. M.K., Specialist i Përgjithshëm në SPSH N., O., që t'ia paguajë shumën prej 1000.00 €. Përbaruesi Privat M.R., duke vendosur sipas propozimit të kreditorit ka

lejuar urdhrin përbarimorë P.nr.1453/2022 të datës 16.11.2022, me të cilin ka urdhëruar debitorin që kreditorit t'ia paguajë shumën prej 1.000.00 €, si dhe shpenzimet e procedurës përbarimore, nën kërcënim të përbarimit të dhunshëm. Pas paraqitjes së prapësimit nga debitori Gjykata Themelore në Prizren - Departamenti i Përgjithshëm ka nxjerrë aktvendimin PPP.nr.05/2023 të datës 09.03.2023, me të cilin është shpallur jo kompetente në pikëpamje lëndore dhe lëndën ia ka dërguar Gjykatës Komerciale të Kosovës për vendosje.

Për të vendosur lidhur me atë se cila prej këtyre dy gjykatave ka kompetencë lëndore në këtë çështje përbarimore, Gjykata Supreme e Kosovës i është referuar bazës ligjore si në vijim. Me nenin 1 të Ligjit për Procedurën Përbarimore përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon procedurën përmes së cilës Gjykatat dhe përbaruesit privat përcaktojnë dhe zbatojnë përbarimin në bazë të dokumenteve përbarues dhe dokumenteve të besueshme, përveç nëse me ligj të veçantë parashihet ndryshe.”* Me nenin 12 paragrafi 1 të Ligjit për Gjykatat nr.06/L-054, i shpallur në Gazetën Zyrtare nr. 22, datë 18 dhjetor 2018, përcaktohet se: *“Gjykatat themelore janë kompetente për të gjykuar në shkallë të parë të gjitha çështjet, përpos nëse me ligj parashihet ndryshe”.* Me nenin 13 paragrafi 1 të Ligjit për Gjykatën Komerciale, përcaktohet se: *“Gjykata Komerciale është kompetente për të gjykuar, dhe ka juridiksion ekskluziv për të gjykuar, në Dhomat e Shkallës së Parë dhe Dhomat e Shkallës së Dytë: 1.1. kontestet ndërmjet shoqërive tregtare vendore dhe të huaja, si dhe kontestet ndërmjet personave juridikë publikë dhe privat, në lidhje me çështjet e ndërsjella tregtare dhe çështje tjera mes tyre, dhe 1.2. të gjitha mjetet juridike, siç përcaktohet me ligjin e aplikueshëm për procedurën përbarimore, për çështje brenda kompetencës të kësaj gjykate”.*

Mbi këtë bazë Gjykata Supreme vlerëson se në këtë rast kompetent për të vendosur në këtë çështje përbarimore është Gjykata Themelore në Prizren - Departamenti i Përgjithshëm, për faktin se titulli përbarimor në bazë të cilit është paraqitë propozimi për përbarim dhe është lejuar përbarimi ka të bëjë me subjektin fizik (debitori është doktori që është gjobitur për ushtrim të profesionit në kundërshtim me parimet etike dhe profesionale) dhe jo me persona juridik, pra debitori nuk e ka statusin e shoqërisë tregtare e as të subjektit publik, por i njëjti është person fizik, andaj Gjykata Themelore në Prizren, mbi bazën e këtyre rrethanave nuk ka mundur të shpallet jo kompetente në pikëpamje lëndore por është dashur të vazhdoj në trajtimin e rastit.

Nga sa u tha më lart, e në kuptim të dispozitës së nenit 25.2 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS – PRISHTINË

CN.nr.127/2024, datë 19.03.2024

Kryetari i kolegjit - gjyqtari
Zenel Leku